



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 24, datë 28.04.2015**

**MBI**

**MIRATIMIN E NËNSHKRIMIT TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNITIT MIDIS  
AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE DHE DREJTORISË SË  
PËRGJITHSHME TË PARANDALIMIT DHE PASTRIMIT TË PARAVE**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 18, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 16, pika 4, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, me propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e Nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**  
**Enkeleda SHEHI**

# **MARRËVËSHJE BASHKËPUNIMI**

Ndërmjet

## **AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE**

Dhe

## **DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE**

Duke parë nevojën për bashkëpunim dhe mirëkuptim dypalësh, në mënyrë që të lehtësohet kryerja e funksioneve të tyre përkatëse mbikëqyrëse;

### **BIEN DAKORT:**

Të lidhin këtë marrëveshje si më poshtë:

#### **Neni I PARIME TËPËRGJITHSHME**

1. Kjo marrëveshje synon sigurimin e ndihmës reciproke në drejtim të lehtësimit të shkëmbimit të informacionit bashkëpunimit midis dy institucioneve: Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.
2. Shkëmbimi i informacionit dhe bashkëpunimi do të bëhet vetëm nëpërmjet mënyrave të lejuara nga dispozitat në fuqi që rregullojnë kuadrin ligjor të funksionimit të dy institucioneve.
3. Përcaktimet e kësaj marrëveshjeje, nuk mund të cenojnë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e secilit prej institucioneve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, në bazë të të cilit këto institucione janë krijuar dhe funksionojnë.
4. Institucionet njohin kërkesën për shkëmbimin e informacionit ose bashkëpunim, në bashkërendim me ligjet respektive ose kërkesat rregullatore. Kërkesa mund të mos plotësohet në këto situata:

- a) Kur informacioni i kërkuar është në kundërshtim me ndonjë ligj apo akt që rregullon ruajtjen e konfidencialitetit;
- b) Kur kërkesa nuk është bërë në përputhje me dispozitat e vendosura në këtë marrëveshje.

## **Neni 2 INSTITUCIONET NËNSHKRUESE**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave është një institucioni publik, në varësi të Ministrisë së Financave, i cili vepron si Njësi e Inteligjencës Financiare të Shqipërisë, në bazë dhe për zbatim të Ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit" i ndryshuar.
2. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (në vijim AMF) është person juridik publik, i pavarur, i cili vepron në bazë dhe për zbatim të Ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar.

## **Neni 3 QËLLIMI DHE OBJEKTI I MARRËVESHJES**

1. Marrëveshja ka si qëllim bashkëpunimin nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, kryerjes së inspektimeve të përbashkëta, si dhe kryerjes së trajnimeve të përbashkëta, në funksion të luftës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ose aktiviteteve të lidhura me to.
2. Rritjen e rolit mbikëqyrës, me qëllim forcimin e sistemit parandalues në vend.
3. Përcaktimet e kësaj marrëveshje nuk kanë për qëllim të tejkalojnë parashikimet ligjore mbi bazë dhe për zbatim e së cilave lidhet kjo marrëveshje.

## **Neni 4 PARIMET E MARRËVESHJES**

Bashkëpunimi i palëve në kuadër të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit do të udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

- a) Identifikimi në kohën e duhur i rasteve dhe situatave, të cilat kanë lidhje me pastrimin e parave kërkon që palët, secili më vete dhe/ose së bashku, të sigurojnë një proces të vazhdueshëm dhe të plotë të mbikëqyrjes së bursës, çdo subjekt tjetër (agjent, broker, shoqëri komisionere, etj.), që ushtron veprimtari për emetimin, këshillimin, ndërmjetësimin, financimin dhe çdo shërbim tjetër që ka lidhje me tregtimin e titujve dhe shoqërive që merren me sigurimin e Jetës ose risigurimin, agentët apo ndërmjetësit e tyre, si dhe fondet e pensionit dhe fondet e investimit duke identifikuar në kohë rreziqet dhe rastet e dyshimta;

- b) Përcaktimi i saktë i përgjegjësive, i cili do të realizohet duke u mbështetur në kuadrin ligjor ekzistues, duke siguruar kështu rritjen e efikasitetit dhe të përgjegjshmërisë së palëve për veprimet e kryera, në raport me çështjet që trajtohen;
- c) Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i rregullt i informacionit, në zbatim të përcaktimeve e të frymës së legjislativës në fuqi dhënë nëpërmjet komunikimit dhe takimeve të rregullta, në mënyrë që secila palë të përmbushë përgjegjësitë e saj ligjore në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe të parandalimit të financimit të terrorizmit.

## **Neni 5**

### **ANGAZHIME TË PËRBASHKËTA TË PALEVE**

1. Palët në këtë marrëveshje informojnë periodikisht për çështjet e mos përputhshmërisë, rezultatet e inspektimeve, ecurisë statistikore të raportimit të RAD-ve dhe masat administrative.
2. Palët hartojnë një plan vjetor të përbashkët inspektimesh, i cili përcaktohet brenda tremujorit të parë të vitit, duke marrë në konsideratë edhe planet individuale të inspektimeve të secilit institucion.
3. Palët shkëmbejnë çdo vit, brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, informacion të shkruar mbi:
  - a) Rezultatet e inspektimeve në vend, të kryera nga secili autoritet më vete në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
  - b) Masat administrative dhe mbikëqyrëse që janë marrë ndaj subjekteve.
4. Palët hartojnë një plan vjetor trajnimesh, i cili përcaktohet brenda tremujorit të parë të vitit
5. Palët bashkëpunojnë dhe ofrojnë asistencë të specializuar, sipas veprimtarisë së tyre, në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit në varësi të kërkesave nga të dy palët si për shembull, interpretime ligjore apo rregullatore, etj.
6. Palët bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë opinione në rastet e hartimit ose ndryshimit të akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
7. Palët bashkëpunojnë për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive në kuadër të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në institucionet ndërkombëtare të angazhuara në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
8. Palët bashkëpunojnë për shkëmbimin e praktikave më të mira në nivel ndërkombëtar në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të dhënave të natyrës strategjike apo atyre që kanë lidhje me vlerësime apo analiza sektoriale.

## **Neni 6**

### **TË DREJTAT DHE DETYRIMET E AMF-së**

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në kuadër të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi do të:

1. Raportojë pranë DPPP çdo dyshim, informacion ose të dhënë, që lidhet me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, për institucionet e mbikëqyrura nga AMF, të konstatuara gjatë procesit të licencimit dhe të inspektimeve.
2. Ndërmarrë masat e nevojshme për të raportuar pranë DPPP, me qëllim që një person i dyshuar për kryerjen e veprimtarisë së pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të mos zotërojë, mos kontrollojë ose të mos marrë pjesë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në pronësinë e aksioneve, drejtimin, administrimin ose veprimtarinë e një subjekti nën mbikëqyrjen e AMF-së.
3. Kërkojë informacion nga DPPP në rastet e transferimit të aksioneve të subjekteve nën mbikëqyrje nga aksionarët ekzistues tek aksionarë të rinj, duke përjashtuar rastet kur aksionarët e rinj janë subjekte me reputacion dhe të mbikëqyrura.
4. Dërgojë në DPPP të dhëna statistikore për numrin e subjekteve të licencuar. Ky informacion dërgohet 1 herë në vit.
5. Dërgojë në DPPP të dhëna statistikore për numrin e subjekteve të cilëve u është revokuar/pezulluar licenca. Ky informacion dërgohet 1 herë në vit.
6. Mbikëqyr veprimtarinë e subjekteve që licencen në lidhje me përmbushjen e detyrimeve ligjore për PPP/FT dhe informon DPPP në çdo rast të konstatimit të mospërmbushjes së këtyre detyrimeve.

#### **Neni 7**

### **TË DREJTAT DHE DETYRIMET E DPPP-së**

DPPP në kuadër të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi do të:

1. Njoftojë AMF-në, kur vëren se një subjekt nuk i përmbush detyrimet e përcaktuara në Ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar.
2. Dërgojë në AMF, raporte statistikore mbi numrin e RAD-ve për secilin subjekt dhe treguesit/anomalitë e këtyre RAD-ve, mbi baza vjetore.
3. Dërgojë për mendim projektligjet ose projektet e akteve nënligjore në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
4. Informojë AMF-në mbi vlerësimet e rrezikut në nivel vendi sipas fushave dhe sektorëve me rrezik.

#### **Neni 8**

### **PROCEDURA PËR SHKËMBIMIN E INFORMACIONIT**

1. Në përputhje me ligjin, palët do të bashkëpunojnë për të mbledhur dhe analizuar informacionin, të cilin e disponojnë lidhur me transaksionet financiare, të dyshuara si të lidhura me aktivitetin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
2. Çdo shkëmbim informacioni sipas kësaj marrëveshje bëhet me shkrim.
3. Informacioni ose dokumentet e marra nga palët, është/janë konfidencial dhe nuk do t'i shpërndahen palëve të treta, pa miratimin paraprak me shkrim të palëve në këtë marrëveshje, përveçse kur në ligj parashikohet ndryshe.

4. Palët nuk do të lejojnë përdorimin apo dhënien e çdo informacioni ose dokumenti të marrë nga palët përkatëse për qëllime të tjera nga ato të përmendura në këtë marrëveshje bashkëpunimi, përveçse kur në ligj parashikohet ndryshe.

## **Neni 9**

### **PERSONAT E KONTAKTIT**

Për të lehtësuar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit sipas kësaj marrëveshje, palët përcaktojnë personat e kontaktit dhe të gjitha komunikimet ndërmjet palëve do të realizohen nëpërmjet tyre, përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe. Personat e kontaktit përkatësisht sipas palëve do të jenë si me poshtë:

AMF - përfaqësohet nga Violanda THEODHORI, Drejtor i Departamentit të Çështjeve Juridike

DPPPP - përfaqësohet nga Agim MUSLIA Drejtor i Drejtorisë së Përputhshmërisë dhe TI.

## **Neni 10**

### **KOSTOT FINANCIARE**

Në rastet kur përmbushja e kërkesave të kësaj marrëveshje kërkon kosto financiare, palët do të angazhohen për marrjen përsipër të tyre respektivisht, në përputhje me rregullat e tyre institucionale.

## **Neni 11**

### **NDRYSHIMET DHE HYRJA NË FUQI**

Marrëveshja e Bashkëpunimit mund të ndryshohet dhe revokohet në çdo kohë nga palët. Çdo ndryshim i parashikimeve të kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi do të bëhet me shkrim.

Marrëveshja hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët.

Kjo marrëveshje u hartua në 3 (tre) njësi origjinale në gjuhën shqipe.

**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

Përfaqësuar nga

**Enkeleda SHEHI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE**

Përfaqësuar nga

**Genti GAZHELI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**